VENDIM
Nr. 134, datë 17.9.2012

MBI KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË "KESH" SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË "CEZ SHPËRNDARJE" SHA (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 1.1.2012 DERI MË 31.12.2014

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa "A" pika 2 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, pikës V.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 17.9.2011, pasi u njoh me propozimin e KESH sh.a. me nr. 1906 prot., datë 4.5.2012, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, mbi kontratën "Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë "KESH" sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 deri më 31.12.2014",

konstatoi se:

Palët e kësaj kontrate KESH sh.a/FPSH dhe OSSH/FPP, janë të licencuara nga ERE përkatësisht:

- "CEZ Shpërndarje" sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 9, datë 25.1.2008, i ndryshuar;
- "KESH" sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 11, datë 23.6.2006, i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë "KESH" sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2012 - 31.12.2014 me ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin e efektet nga data 1 janar 2012 deri në datën 31 dhjetor 2014.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

TEKSTI I NDRYSHIMEVE TË KONTRATËS

1. Në pikën 1 të nenit 3 të kontratës, fjalia e parë ndryshohet si vijon:

"Shitësi do të sigurojë energjinë elektrike në përputhje me sasinë e energjisë elektrike të planifikuar për efekt të përllogaritjes së tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, në kohën dhe në sasinë siç do t'ia tregojë blerësi shitësit, sipas përcaktimeve të Modelit dhe Rregullave të Tregut.".

2. Pika 8.3.i e kontratës, riformulohet:

"i- Në rastin e importit të një sasie më të madhe, "KESH" sh.a. do t'i kompensojë "CEZ Shpërndaje", këtë diferencë pozitive me energji elektrike deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, "KESH" sh.a. është i detyruar të kompensojë "CEZ Shpërndarje" sh.a. në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuara nga "CEZ Shpërndarje" për sigurimin e kësaj sasie të energjisë elektrike.".

3. Pika 8.3.ii e kontratës, riformulohet:

"ii- Në rastin e importit të një sasie më të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, "CEZ Shpërndarje" do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga "KESH" sh.a., deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, "CEZ Shpërndarje" sh.a. është i detyruar të kompensojë "KESH" sh.a. në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuara nga "KESH" sh.a. për sigurimin e kësaj sasie të energjisë elektrike.".

4. Pika 8.3.iii, shfuqizohet.

5. Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë ai i aprovuar nga ERE sipas vendimeve përkatëse për përcaktimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore”.

6. Neni 15, pika 1, pas fjalëve “në favor të shitësit” të shtohen fjalët: “garancinë bankare në vlerën monetare që i korrespondon ½ së sasisë mesatare mujore të energjisë elektrike të planifikuar...”.

7. Neni 22 pika 1, ndryshohet si vijon:

“Kjo kontratë dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2012 deri 31 dhjetor 2014”.

8. Në shtojcën 1 të kontratës, shtohet termi i mëposhtëm:

“Kosto reale – ka kuptimin e të gjitha shpenzimeve që identifikohen nga kompania për sigurimin e energjisë elektrike nga burimet përkatëse, përfshirë edhe të gjitha kostot shtesë të paparashikuara (*overdraft*), si dhe çdo vlerësim mbi impaktin e transaksionit në treguesit e eficencës së përdorimit të rezervave ujore”.